



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E SHTIMES  
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Arsim,  
Uprava za Obrazovanje /Department of Education.

Nr i Prot 05/203

Datë: 16.04.2024

Duke u bazuar nw Rregulloren Komunale për Ndarjen e Bursave pwr Studentw Npi-01/209 e datë 31.05.2023, dhe në bazë të vendimit të Kryetarit të Komunës së Shtimes për caktimin e shumës për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2023/2024 për vitin fiskal 2024, me nr të protokollit 02/295 të datës 12. 4 .2024, Drejtoria Komunale e Arsimit në Shtime shpall:

**KONKURS  
PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË SHTIMES  
PËR VITIN AKADEMIK 2023/2024**

Komuna e Shtimes ndanë 100 bursa për studentë, që studiojnë në ndonjë nga fakultetet që ofrohet nga bartësit publik dhe bartësit tjerë të arsimit të lartë në Kosovë dhe jashtë vendit që janë të akredituar, për vitin akademik 2023/2024.

- Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore
- Fakulteti i Mjekësisë
- Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës
- Fakulteti i Makinerisë
- Fakulteti i Arteve
- Fakulteti i Shkencave Sportive
- Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinës
- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike
- Fakulteti Filologjik
- Fakulteti Filozofik
- Fakulteti i Edukimit
- Fakulteti Juridik
- Fakulteti Ekonomik

Bursat do të ndahen për 10 (dhjetë) muaj dhe shuma mujore do të jetë 50 €  
Studentët të cilët janë përfitues të bursës në vitin akademik 2022/2023 nga konkursi paraprak janë të obliguar të riaplikojnë.

**KRITERET**

- I. Kuadri deficitar në komunën e Shtimes
- II. Suksesi më i mirë i studentit
- III. Gjendja e vështirë sociale

- IV. Student i rregullt në ndonjërin nga fakultetet që ofrohet nga bartësit publik dhe bartësit tjerë të arsimit të lartë në Kosovë dhe jashtë vendit që janë të akredituar.

**Në numrin rendor –I- Përparësi do të kenë:**

1. Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore
2. Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës.
3. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike.
4. Fakulteti i Mjekësisë, Programi: Mjekësi e Përgjithshme
5. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinës, Programi: Mjekësi Veterinare
6. Fakulteti i Filologjisë, programi: Gjuhë dhe Letërsi Gjermane

**Në numrin rendor –II-, Përparësi do të kenë:**

1. Suksesi (Nota mesatare, 7 e më lart)
2. Studentët e rregullt që kanë të mbaruar vitin e parë të studimeve.

**Në numrin rendor –III-, Përparësi do të kenë:**

1. Gjendja më e rëndë sociale
2. Në kushtet e njëjta për pikat I,II,III dhe IV përparësi do të kenë:

- a) Studenti-ja, fëmijë i invalidit të luftës
- b) Studenti-ja, fëmijë i veteranit të luftës,
- c) Studenti-ja. Fëmijë i martirit-es së luftës.
- d) Studenti-ja, me gjendje të rëndë sociale,
- e) Studenti-ja, që është me aftësi të kufizuara,
- f) Studenti-ja , pa prind ose në mbikëqyrje të nënës,
- g) Studenti i prindit të burgosur politik,
- h) Studenti që ka fituar shpërblim kombëtar ose ndërkombëtar në lëmin e arsimit.

Për t'gjitha këto kategori gjatë aplikimit duhet të sjellin dëshmitë nga shoqatat dhe institucionet përkatëse.

**Në numrin rendor –IV-, Përparësi do të kenë**

1. Student i rregullt në ndonjërin nga fakultetet që ofrohet nga bartësit publik dhe bartësit tjerë të arsimit të lartë në Kosovë dhe jashtë vendit që janë të akredituar.
2. Studenti-ja banor-rezident i komunës së Shtimes,
3. Studenti-ja, i cili ka dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak

**DOKUMENTACIONI QË KËRKOHET PËR KONKURIM:**

1. Kërkesa (Aplikacioni) sipas formës së Komunës,
2. Kopja e letërnjoftimit
3. Kopja e indeksit, apo ID-kartelës
4. Certifikata e notave dhe vërtetimi për statusin e studentit (original)
5. Certifikatën mbi vendbanimin e përhershëm,
6. Vërtetimi që studentin nuk është përfutur i bursës universitare.

Fëmijëve të dëshmorëve u ndahen bursat me automatizëm nga viti i parë i studimeve, por në rast të përsëritjes së vitit, studentin e humb të drejtën për bursë

Të drejtën në bursë studentin përsëri mund ta shfrytëzojë vetëm pas dorëzimit të dëshmisë për regjistrimin e vitit vijues të studimeve në njërin fakultet.

Komisioni Komunal për ndarjen e bursave do të bëjë përzgjedhjen e studentëve sipas kriterëve të përcaktuara në këtë konkurs dhe konform Rregullores Komunale për Ndarjen e Bursave për Studentë të Komunës së Shtimes.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen të kompletuara sipas kërkesës me këtë konkurs në Drejtorinë Komunale të Arsimit, Kati i III-të, në ndërtesën e Komunës së Shtimes.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë prej ditës së shpalljes në web-faqen zyrtare të Komunës së Shtimes dhe tabelën e shpalljeve të Komunës.

Drejtoresha:

Yllka Fejzullahu

